



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKAsë, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Përkundër që Ministria kishte implementuar të gjitha rekomandimet e dhëna në raportin e vitit 2020, gjatë këtij auditimi janë identifikuar disa mangësi të cilat duhet të trajtohen nga Ministria. Fushat në të cilat duhet përmirësim kanë të bëjnë me detyrimet kontigjente, vonesat në realizim të projekteve kapitale si dhe mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë. Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime të reja.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

#### **Çështja A1 - Nënvlërësim i detyrimeve kontigjente dhe mbivlerësim i pasurise kapitale në pasqyrat financiare**

##### **Gjetja**

Neni 1 i rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Po ashtu, sipas nenit 6 - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Nga rishikimi i PFV të Ministrisë si dhe krahasimi i tyre me shënimet e SIMFK identifikuam gabimet si në vijim:

- Tek Neni 18 – Detyrimet kontigjente ishin nënvlerësuar për 71,779€. Kjo kishte ardhur si rezultat i prezantimit të detyrimeve kontigjente vetëm për vitin 2021, por jo edhe ato të vitit 2020; dhe
- Tek Neni 19.3.1 – Pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte mbivlerësuar për vlerën prej 73,431€.

Shpalosja jo e saktë e detyrimeve kontigjente kishte ndodhur për shkak të moskordinimit të mirë ndërmjet Departamentit ligjor - Avokaturës Shtetërore dhe zyrës së financave. Mbivlerësimi i pasurive ka ndodhur si rezultat i kontroleve joadekuate në lidhje me menaxhimin e pasurisë.

##### **Ndikimi**

Këto lëshime në PFV kanë rezultuar në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare në kategoritë e caktuara.

##### **Rekomandimi A1**

Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2022. Pasqyrat financiare të mos dorëzohen në Thesar-MFPT para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 753,425€, prej tyre ishin shpenzuar 663,135€. Ato kanë të bëjnë me renovimin e objekteve të burgjeve, furnizim me automjete, blerjen e pajisjeve, instalimin e kamerave në Shërbimet Korrektuese etj.

### Çështja A2 - Vonesa në përfundimin e projekteve kapitale të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK)

**Gjetja** Sipas kontratave publike për punë në mes Ministrisë dhe Operatorëve ekonomik, koha e përfundimit të punëve është 60, përkatësisht 90 ditë pune.

Gjatë auditimit të projekteve kapitale, në dy raste kemi vërejtur vonesa në përfundimin e projekteve, si në vijim:

- Sipas kontratës “Renovimi i brendshëm i portës së re në Qendrën Korrektuese në Dubravë” me vlerë 44,862€, punimet është dashur të përfundojnë me 23.09.2021, ndërsa gjatë kohës sa ne ishim në auditim (datë 12.04.2022), projekti kishte përfunduar vetëm 70%; dhe

- Sipas kontratës “Ndarja e hyrjes për vizitorë në Q.P Gjilan” me vlerë 58,492€, punimet është dashur të përfundojnë më 19.10.2021 dhe gjatë kohës sa ne ishim në auditim ishte marrë vendimi për shkëputje të kontratës dhe tërheqje të sigurimit të ekzekutimit, megjëse vetëm 30% të punimeve kishin përfunduar.

Sipas zyrtarëve vonesat kanë ndodhur për shkak të natyrës specifike të punëve në SHKK, ku kryesisht vetëm furnizimet kontraktohen, ndërsa realizimi i punëve bëhet nga të burgosurit. Vonesat ishin përcjellë edhe nga situata pandemike.

**Ndikimi** Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese si dhe rrisin rrezikun për kosto shtesë për zhvillimin e procedurave të reja për kontraktim në rast të shkëputjes së kontratave.

**Rekomandimi A2** Ministrja në bashkëpunim me SHKK-në duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e projekteve të filluara dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme për të siguruar realizimin e projekteve të ardhshme sipas planit kohor të përcaktuar me kontratë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 95,204,094€, pasurive jokapitale është 893,691€, si dhe e stoqeve 365,697€.

#### Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

##### Gjetja

Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”, si dhe neni 20 përcakton se “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës.” Ndërsa, neni 22.3 thekson se të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Lidhur me menaxhimin e pasurisë në MD kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Në MD, SHKK, Agjencionin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës, komisionet përkatëse kishin bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2021, janë përpiluar raporte gjithëpërfshirëse, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe raportimi i pasurive në PFV ishte bërë sipas regjistrave kontabël.

Komisioni i vlerësimit ishte themeluar vetëm në MD pas hartimit të pasqyrave financiare (datë 25.02.2022) dhe gjatë kohës sa ne ishim në auditim ende nuk e kishin përfunduar detyrën dhe nuk kishin përgatitur ndonjë raport të vlerësimit të pasurisë.

Për më tepër, salldo e pasurive kapitale nën 1,000€ ishte mbivlerësuar, pasi që për pasurinë e SHKK-së në vlerë 745,875€ nuk ishte bërë llogaritja e zhvlerësimit të akumuluar nga viti 2019.

Kjo kishte ndodhur për shkak të strukturës së shpërndarë organizative dhe për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate në lidhje me menaxhimin e pasurisë dhe mos funksionimit të sistemit E-pasuria.

##### Ndikimi

Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë, mungesa e vlerësimit të pasurisë dhe mungesa e zhvlerësimit reflekton në mbi/nënvlerësim të gjendjes së pasurisë. Kjo rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe

njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

**Rekomandimi A3** Ministrja duhet të sigurojë që komisionet për inventarizimin dhe vlerësim të pasurisë të përfundojnë punën e tyre para përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe të bëjnë krahasimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël duke përfshirë edhe zhvlerësimin e akumuluar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>38,865,425</b>	<b>29,333,984</b>	<b>28,222,191</b>	<b>21,347,718</b>	<b>21,468,816</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	38,785,225	29,197,502	28,190,019	21,306,120	21,265,840
Financimi përmes huamarrjes	0	11,221	11,221	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,641	1,641	41,598	58,785
Të hyrat vetanake	80,200	80,200	19,310	0	7,002
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	137,189
Donacionet e jashtme	0	43,420	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 9,531,441€. Ky zvogëlim apo ndryshim i buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore në vlerë prej 9,587,723€, nga të hyrat e bartura 1,641€, financimit të huamarrjes prej 11,221€ si dhe nga vlerës së mbetur të donacioneve 43,420€.

Në vitin 2021, MD ka shpenzuar 96.2% të buxhetit përfundimtar ose 28,222,191€, me një rritje 21% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>38,865,425</b>	<b>29,333,984</b>	<b>28,222,191</b>	<b>21,347,718</b>	<b>21,468,816</b>
Pagat dhe mëditjet	13,737,474	13,362,455	13,301,515	14,498,653	13,410,392
Mallrat dhe shërbimet	6,074,182	7,036,942	6,112,369	5,360,588	5,471,465
Komunalitë	1,070,769	1,044,269	1,040,780	775,129	1,113,013
Subvencionet dhe transferet	17,228,000	7,136,893	7,104,392	68,456	529,597
Investimet Kapitale	755,000	753,425	663,135	644,891	944,348

MD kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 375,019€. Kjo ishte rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave vetanake si dhe vendimit Qeverisë nr. 11/52 për kursime buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 100% e buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 962,760€. Kjo ishte rezultat i rishikimit të buxhetit, donacioneve të bartura, vendimeve të qeverisë, transfereve nga kategoritë tjera, si dhe vendimeve për kursime buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 87% e buxhetit;


- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 26,500€. Kjo ishte rezultat i rishikimit buxhetor, transferit në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe vendimit të qeverisë për shkurtime buxhetore;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 10,091,107€. Kjo ishte rezultat i rishikimit të buxhetit, vendimeve të qeverisë, transferit në kategorinë mallra dhe shërbime, si dhe vendimeve për kursime buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 100% e buxhetit; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,574€. Kjo ishte si rezultat i kursimeve buxhetore nga MFTP. MD kishte realizuar 88% të buxhetit për investime kapitale.

MD për menaxhimin e situatës me Covid 19 kishte shpenzuar 80,033€, prej të cilave 70,306€ ishin shpenzuar për paga dhe shtesa dhe 9,726€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MD në 2021 ishin në vlerë 127,803€. Të hyrat realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të Gjykatave, nga provimi i Jurisprudencës dhe noterisë dhe nga kompensimet e dëmeve nga kompania e sigurimeve. Bazuar në vitin e kaluar shohim një rritje të inkasimit të të hyrave për 63%.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>59,121</b>	<b>191,288</b>	<b>127,803</b>	<b>78,244</b>	<b>267,333</b>
Të hyrat jo tatimore	59,121	191,288	127,803	78,244	262,939
Të hyrat tjera	0	0			4,393

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Ministrisë së Drejtësisë ka rezultuar në 5 (pesë) rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, të gjitha rekomandimet ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministrja e MD, përkatësisht Drejtori i përgjithshëm i IML-së duhet të sigurojë që pagesat e gatishmërisë të bëhen në përputhje me vlerën e përcaktuar në KKS dhe rregulloret tjera financiare.	Bazuar në testimet e mostrave për paga dhe mëditje, Ministria konkretisht IML kishte zbatuar rekomandimin duke siguruar që pagesat e gatishmërisë të realizohen konform vlerës së përcaktuar në KKS.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Ministrja e MD duhet të kontrolloj dhe siguroj që të gjitha pagesat për shtesa në paga të punonjësve administrativ të SHKK-së bëhen sipas vendimeve të Qeverisë, Ligjit për ndarjet buxhetore dhe rregulloret tjera financiare për shpenzimin e parasë publike.	Rekomandimi ishte zbatuar ngase në vitin 2021 ishte pezulluar vendimi i Qeverisë për pagesën e shtesave për rrezikun e infektimit në punë dhe SHKK nuk kishte bërë asnjë pagesë për shtesat e Covid 19.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Ministrja duhet të sigurohet se barazimi i të hyrave të MD me Thesarin bëhet në baza mujore, në mënyrë që ministria të ketë pasqyrën e plotë dhe të saktë të të hyrave dhe të eliminohen mos përputhjet e gjendjes kontabël.	Në vitin 2021 ishte bërë barazimi i të hyrave në baza mujore me Thesarin.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregulloret në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa	Pas pranimit të raportit të auditimit, nuk ka pasur raste ku urdhërblerja dhe zotimi janë procesuar pas pranimit të faturës.	I zbatuar
5.	Obligimet e papaguara	Ministrja duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara do të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat përmes procedurave gjyqësore dhe procedurave përbarimore.	Pas pranimit të raportit të auditimit, nuk ka pasur vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara.	I zbatuar



Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti, Udhëheqëse e ekipit




Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Datë: 17.05.2022

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2021

Për: **Vlora Spanca**, Auditore e Përgjithshme

**Emine Fazliu**, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2021;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### *Forma e opinionit*

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> 1. Kontrata publike për punë “Renovimi i brendshëm i portës së re në qendrën korrektuese në Dubravë” e datës 15.06.2021 me vlerë 44,862€, sipas kushteve të vecanta data e përfundimit të të gjitha punëve është për 60 ditë pune. 2. Kontrata publike për punë “Ndarja e hyrjes për vizitorë në Q.P Gjilan” e datës 19.05.2021 me vlerë 58,492.60€, sipas kushteve të vecanta data e përfundimit të të gjitha punëve është për 90 ditë pune. 3. Kontrata publike për punë “Ndërtimi i pemishtës në qendrat e SHKK-së” e datës 22.09.2021 me vlerë 12,388€, sipas kushteve të vecanta data e përfundimit të të gjitha punëve është për 90 ditë pune.
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.